



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Tiranë, më datë 15.10.2020

Nr. 948 Prot.

VENDIM
Nr. 357, datë 15.10.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të koncept sondazhit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.10.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e koncept sondazhit në kuadër të projektit “Agroturizëm Bote Farms”, Finiq, me aplikues Bote Farms realizuar nga person i licencuar në arkeologji z. Ols Lafe;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji për realizimin e sondazheve arkeologjike dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e sondazheve arkeologjike për projektin e “Agroturizëm Bote Farms” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 3. Raporti i rezultateve të sondazheve do të kalojnë për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM-në e radhës.
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

